



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 13 korrik 2018, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, për ofrimin e shërbimit të subjektit audio të komunitetit “Radio Ngjallja” në “Qarqet Fier, Elbasan dhe Korçë”, dhe reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit në “Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës dhe Shijak” (**Vendimi nr. 134, datë 13.07.2018**)
2. Rrëzimin e kërkesës së subjektit person fizik Lulzim Spata, për rishikimin e vendimit të AMA-s, Nr. 90, datë 16.05.2018 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të subjektit person fizik Lulzim Spata, për rinovimin e licencës së subjektit audioviziv privat vendor “Tv Kruja” (**Vendimi nr. 135, datë 13.07.2018**)
3. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “4 Plus Media Group” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të AMA-s nr. 122, datë 08.06.2018 “Për heqjen e licencës së shoqërisë “4 Plus Media Group” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “Tv 4+”; (**Vendimi nr. 136, datë 13.07.2018**)
4. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “ABCCom” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “ABCCom” (**Vendimi nr. 137, datë 13.07.2018**)
5. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Besnik Deliu, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor KAM”; (**Vendimi nr. 138, datë 13.07.2018**)
6. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Irla” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor IRLA” (**Vendimi nr. 139, datë 13.07.2018**)
7. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Procom” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Procom”. (**Vendimi nr. 140, datë 13.07.2018**)

8. Dhënien e autorizimit shoqërisë "I.B.C.-Telecom" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT). **(Vendimi nr. 141, datë 13.07.2018)**
9. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit Bardhyl Tosku autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv kabllor Asparag", në njësitë administrative Gjocaj, Karinë, Tërbuf dhe Dushk" **(Vendimi nr. 142, datë 13.07.2018)**
10. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Eduart Feka, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Kuçova", në Bashkinë Patos dhe Njësitë Administrative Fier Shegan, Cakran dhe Mbrostar Ura" **(Vendimi nr. 143, datë 13.07.2018)**
11. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit Mikel Jaho, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv kabllor Toshkëz", në Njësinë Administrative Kryevidh" **(Vendimi nr. 144, datë 13.07.2018)**
12. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Eltion Thanasi autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv kabllor APT" për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në njësinë administrative Çërravë" **(Vendimi nr. 145, datë 13.07.2018)**
13. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Shaban Merkaj, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Lapardha", në "Njësinë Administrative Lumas" **(Vendimi nr. 146, datë 13.07.2018)**
14. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e autorizimit, shoqërisë "Luva Group" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Luva " **(Vendimi nr. 147, datë 13.07.2018)**
15. Mosrinovimin e autorizimit të shoqërisë "Cable Albania Kavajë" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Cable Albania Kavajë" **(Vendimi nr. 148, datë 13.07.2018)**
16. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e autorizimit, subjektit person fizik Edmond Çuli, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv kabllor IBEG4" **(Vendimi nr. 149, datë 13.07.2018)**
17. Pranimin e kërkesës së shoqërisë "Big Fm" sh.p.k., për kalimin e të drejtave të licencës së shoqërisë "Radio +2" sh.a., licencuar për subjektin audio privat vendor "Radio +2" tek shoqëria "Big Fm" sh.p.k. **(Vendimi nr. 150, datë 13.07.2018)**
18. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë të shoqërisë "Egnatia Televizion" sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor "Club Tv" **(Vendimi nr. 151, datë 13.07.2018)**
19. Pranimin e kërkesës së shoqatës "Radio Maria" licencuar për radion komunitare "Radio Maria", për ndryshimin e kushteve teknike të licencës." **(Vendimi nr. 152, datë 13.07.2018)**
20. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë të shoqërisë "Top Albania" sh.a., licencuar për subjektin audio kombëtar "Top Albania Radio" **(Vendimi nr. 153, datë 13.07.2018)**
21. Rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit me gjobë nr. 9, datë 28.05.2018, vendosur ndaj shoqërisë "Alfa & Omega" sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat vendor "Alfa & Omega" **(Vendimi nr. 154, datë 13.07.2018)**
22. Rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit me gjobë, Nr. 10, datë 29.05.2018, në masën 5,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit/apo AMA"

- ndaj subjektit z. Lartment Mato, për ofrimin e shërbimit audioviziv mbështetur në internet, IPTV, pa autorizim. **(Vendimi nr. 155, datë 13.07.2018)**
23. Rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit me gjobë, Nr. 11, datë 29.05.2018, në masën 5,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit/apo AMA ndaj subjektit z. Skerdilajd Muho, për ofrimin e shërbimit audioviziv mbështetur në internet, IPTV, pa autorizim. **(Vendimi nr. 156, datë 13.07.2018)**

Tiranë, 13 korrik 2018

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE